

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Korça drejt gazifikimit, nisin studimet ne terren: Projekti pilot, alternativë e re për ngrohjen dhe energjinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/korca-drejt-gazifikimit-nisin-studimet-ne-teren-projekti-pilot-alternat-i585559
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 09:12:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 09:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	100754af6f55b5c2ddc08395fb142d28a683a88c8bc68a643c4efaf690975029
TEKSTI	f2c9942b2ee346f7b5c200886e74b84d95a568047c8afa8a44f1f49aff974705
PAMJA	c16a834190e908591a7d5323d01f0b89f52cd1a0638c224c24416daede999a3f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ba258c2df82eae56a07aaf37431795f72b8a3f91788afa2a7c3f62b656044d6a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ba258c2df82eae56a07aaf37431795f72b8a3f91788afa2a7c3f62b656044d6a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e Beteja e fundit për ish-krerët e UÇK! Rama: Liri për çlirimtarët, I haçi do të triumfojë me forcen e se vertetesMauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin Nderkombëtar "Palmyra"Putur fundit

Korça drejt gazifikimit, nisin studimet ne terren: Projekti pilot, alternativë e re për ngrohjen dhe energjinë

12 Shtator 2026, 11:30Sociale TEMA



Korça drejt gazifikimit, nisin studimet ne terren: Projekti pilot,

Korça pritet të konkretizojë modernizimin e infrastrukturës së saj energjetike. Në terren, kanë nisur investigimet gjeoteknike dhe gjeofizike për projektin e gazifikimit të qytetit, proces që shënon fazën e parë konkrete të këtij investimi strategjik.

Kryetari i Bashkisë Korçë, Sotirag Filo, e konsideron gazifikimin një projekt me rëndësi të veçantë zhvillimi, veçanërisht për përmirësimin e mënyrës së furnizimit me energji dhe ngrohjes së banesave.

Projekti me një kosto të parashikuar rreth 21 milionë euro, parashikon krijimin e një rrjeti modern për shpërndarjen e gazit natyror, duke u ofruar familjeve dhe bizneseve, alternativë të re energjetike. Për një qytet si Korça, ku stina e dimrit është më e ftohtë krahasimisht me zona të tjera në vend, një sistem më eficient ngrohjeje, mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të banorëve.

Ndërkohë, përfitimet nuk lidhen vetëm me familjet. Gazifikimi mund t'u krijojë bizneseve mundësi për të ulur shpenzimet energjetike dhe për ta përdorur gazin në procese të ndryshme teknologjike, duke ndikuar në rritjen e eficiencës dhe konkurrueshmërisë së tyre.

Investigimet që po zhvillohen aktualisht, kanë rol të rëndësishëm për vijimin e këtij projekti. Përmes studimit të karakteristikave të terrenit, do të përcaktohen kushtet teknike dhe mënyra më e përshtatshme për shtrirjen e infrastrukturës së re energjetike.

Në një perspektivë më të gjerë, projekti synon ta afrojë Korçën me një model më modern e të qëndrueshëm të zhvillimit urban. Përdorimi më eficient i energjisë, reduktimi i kostove dhe ndikimi më i ulët në mjedis, janë disa prej objektivave që lidhen me këtë investim. Gazifikimi me rrjetin e ri, shihet ndërhyrje që mund të ndikojë në mënyrën se si qyteti i Korçës do të furnizohet dhe ngrohet në vitet e ardhshme.

Nga studimet në terren te ndërtimi i infrastrukturës, ka nisur hapi i parë dhe synimi është që Korça, të ketë një sistem energjetik më modern, më eficient dhe më të përshtatshëm. Financimi për këtë projekt lidhet me bashkëpunimin Shqipëri - Azerbajxhan. Memorandumi u nënshkrua në Nëntor 2024, ndërsa në Prill 2025, ai u prezantua zyrtarisht si projekt pilot, ku Korça u zgjodh si qyteti ku do të testohet modeli përpara shtrirjes së gazifikimit edhe në qytete të tjera.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Nesër në Apolloni të Fierit, Gjergj Luca hap kompleksin e trete Fish City në Shqipëri](#)

21:19 Sociale / 2 komente

[‘Siguria kibernetike’ do mësohet për herë të parë në shkolla, lëndë më zgjedhje për klasat e para, të gjashta e të dhjeta](#)

19:20 Sociale

[Siguria kibernetike, për herë të parë lëndë mësimore](#)

17:20 Sociale / 2 komente

[Banorët akuza “Bankers”: Nuk na kanë paguar qiranë e tokës](#)

16:30 Sociale / 1 koment

[Bie numri i maturantëve, por rritet ai i studentëve të rinj](#)

16:20 Sociale / 1 koment

[Inspektorët me kamera inteligjente, Dash Sula: Kontrollët do të përcaktohen nga sistemi i ri, qytetarët të denoncojnë](#)

15:50 Sociale / 1 koment

[Ministri Salla: Siguria ushqimore e fëmijëve, pa kompromis. AKU intensifikon kontrollët me nisjen e vitit shkollor](#)

15:33 Sociale

[88 nxënës fitues të olimpiadave vlerësohen në Kryeministri, Rama: Jeni frymëzim! Mos u dorëzoni dhe mos e tradhtoni kurrë ëndrrën që keni](#)

15:35 Sociale

[Vlerësohen 88 olimpiadistë, Kumbaro: Ju jeni prova që s’mund të vareni nga teknologjia, por ta keni në duart tuaja për të zhvilluar mendimin kritik](#)

14:59 Sociale

[Rregullorja censuruese e GJKKO-së shkon në Kushtetuese, gazetarët padi të hënën: Të pezullohet deri në marrjen e një vendimi](#)

14:12 Sociale / 1 koment

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?

10:40 Kronika / 74 komete

Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...

10:50 Politika / 52 komentare

PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë

16:18 Politika / 41 komete

Audiopërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...

11:15 Politika / 74 komete

Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...

11:30 Politika / 36 komete

Blog Tema

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:25 Blog / 2 komete

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:00 Blog / 1 koment

Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK

19:26 Blog / 8 komete

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë

Numri juaj i telefonit

Ju mund të c'regjistrohemi në cdo moment.

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)

Built and Monetized by